

101

Flora
inë
Edukim

Osman Nuri Topbash

PROGRESI
BOTIME



Shkodër, 2011

Përktheu: Artur Tagani
Redaktoi: Edlira Boriçi
Titulli origjinal: Eđitimde 101 Adım



PROGRESI sh.p.k.

Adresa: L: Vasil Shanto Rr: ajupi Shkodër / Shqipëri
Tel: +355 22 25 46 34 Fax: +355 22 25 46 33
Mob: +355 67 20 87787 Mob: +355 67 20 86767
Http: www.progresibotime.com e-mail: botime@progresibotime.com
Design: Bledar Xama

Adresa Kosovë: Rr:Ardian Zurnaxhiu / pn. Ralin / Prizren
Tel: +381 29 222 795 Fax: +381 29 222 797
e-mail: kosova@progresibotime.com

Adresa Maqedoni: Rr: Stiv Naumov / nr. 9 / lokal 25 / Shkup
Tel: +398 71 956 271 e-mail: maqedoni@progresibotime.com

101

Flapra
në

Edukim

Osman Nuri Topbash



Sjala më e bukur

Nga Kurani Famëlartë:

“...bëj mirë, ashtu si dhe Allahu
të bën ty mirë...”

(el-Kasas, 77)

“ ...do të pyeteni për të mirat (e kësaj bote)
kur ajo ditë do të vijë”

(et-Tekathur, 8)





1

Nëna është edukuesja e parë e njeriut,
nga barku i së cilës nis edukimi.





2

Fëmija është amaneti hyjnor që i është dhuruar prindërve dhe mësuesve, përmes të cilit fitohen sevapet.



7





3

Trashëgimia më e vyer që lë prindi tek fëmija është edukata e mirë, karakteri dhe personaliteti i shëndoshë, të cilat arrihen nëpërmjet një shkollimi me cilësi.







4

Njeriu është krijesa që ka më tepër
nevojë për edukim. Arti më në pedestal
në jetë është të edukosh një njeri.
Allahu i Madhëruar dërgoi profetët
si mësuesit më të lartë të njerëzimit,
prandaj të shërbyerit si mësues është
profesion profetik.



5

Mësuesi nuk përçon thjesht dituri,
ai mbjell farën e sinqeritetit tek fëmijët,
formon mendje të mprehta, zgjeron
horizonte të mbyllura, mëson metoda
të jetuari dhe mirësjellje. Pra, ndërton
ndërgjegje të shëndosha.







6

Edukimi i një fëmije nuk mjaftohet me mundësimin e fjetjes dhe ushqimit, kusht është t'i zbukurosh atij shpirtin dhe mendjen me dije dhe me njohje intuitive (gnosë).



7



Mësuesi duhet të jetë i vetëdijshëm që po edukon njeriun e së ardhmes, i cili duhet ta bëjë atë, njeri të interesuar jo vetëm ndaj diturisë sipërfaqësore, por dhe ndaj botës shpirtërore, jo vetëm ndaj fshehtësisë, por dhe ndaj urtësisë.





8



Një mësim që jepet i ndarë nga bota shpirtërore, është i mangët. Ekuilibri materie-shpirt mbetet i padiskutueshëm për një njeri, në të kundërt do të ishte si zogu me një krah, që përpiqet të fluturojë, por që s'do të kthehej në tjetër, veçse në një kafshatë për një mace të uritur.





9

Çdo gjallesë që nuk mund t'i përshtatet rrjedhës së jetës është e predispozuar të fshihet me kalimin e kohës, prandaj Hz. Aliu r.a. ka porositur në këtë mënyrë:
“Edukoni fëmijët sipas kohës që ata do të jetojnë dhe jo sipas kohës që ju jetoni.”





10

Nëse keni një grusht njerëzish sakrifikues, të arsimuar mirë, do jeni një popull i fituar, në të kundërt, do të mbeteni të humbur.





11

Nuk është ndonjë profetësi të parashikosh të ardhmen e një populli. Tregues të mjaftueshëm janë fëmijët dhe të rinjtë e atij vendi. Nëse fuqitë dhe energjitë e tyre i konsumojnë për vlera dhe për botën shpirtërore, atëherë e ardhmja e atij popull është e ndritur, përndryshe, nëse energjitë i shpenzojnë për epsh, atëherë përfundimi është i dhimbshëm.





12

Kapitali kërkon një fushë të vyer për të bërë investim. Arsimimi është fusha më e rëndësishme për këtë. Kalkulimi më i drejtë i së ardhmes është të edukosh njeriun ideal, njeriun me cilësi.



13

Një mësues i mirë duhet të manifestojë
një karakter të shëndoshë,
me të cilin të ngjallë simpati në zemra,
të burojë mëshirë nga shpirti, si dhe të
shpërndajë vullnet, përsheptshmëri
dhe energji pozitive.





14

Është e pamundur të bind të tjerët një njeri që është inkohorent, për ato që thotë dhe për ato që bën.





15

Mësuesi, pikësëpari duhet të bëhet vetë
shembull duke zbukuruar jetën e tij,
para se t'ua rekomandojë
të tjerëve bukuritë.



16

Mësuesi duhet të shpërndajë domosdoshmërisht energji pozitive tek nxënësit e tij, shembull tipik është bota shtazore: ndërkohë që një pulë, i mban nën krahë zogjtë e saj, gjarpëri me shikimin e tij rrit këlyshët e vet, akrepi zogjtë e tij i mban mbi shpinë, po njeriu, vallë ç' duhet të bëjë?





17

Në një vend ku nuk ka siguri dhe besim,
nuk ka arsim me cilësi të duhur. Mësuesit
duhet të jenë manifestuesit e sigurisë tek
të tjerët, me qëllim që nxënësit të ecin
nën gjurmët e tyre, pasi njerëzit i duan
individët shembullorë, me dinjitet dhe
karakter të shëndoshë.



18

Një popull merr formë në sajë të prijësve të tij, ashtu si Periudha e Lumturisë mori formë sipas skicës shpirtërore të Hz. Muhamedit (a.s.), as'habi suffe është shembulli më i qartë për këtë. Abdullah Ibn Mes'udi, një nga nxënësit e suffes, për të shprehur edukatën profetike që kishte marrë, thoshte: *“Dëgjonim dhikrin që bënin kafshatët, ndërsa kalonin në fyt.”*







19

Metoda më e rëndësishme e edukimit e profetit Muhamed (a.s.) ishte biseda fetare, sepse në bisedë fetare ka një marrëdhënie shpirtërore.

Për arsye se biseda fetare merr rrjedhën sipas auditorit, ajo në një farë mënyre është një proces shkrimi recetash për auditorin.







20

Mësuesi duhet ta trajtojë nxënësin e tij sikur të jetë një nga personalitetet më të larta të së ardhmes, pasi nuk duhet të harrojë se mund të ketë në dorë një nga gjenitë, që mund të ndryshojë botën në të ardhmen.



21

Një mësues i mirë nuk duhet të lë pas dore asnjëherë formimin e tij, përpjekja për një progres të vazhdueshëm duhet të jetë atributi më i natyrshëm i tij, për ndryshe, mjaft të zgjuar dhe të talentuar mund të shuhen për shkak të paaftësisë së tyre.







22

Një brez cilësor është vepër e mësuesve cilësorë, me personalitet, plot dije dhe edukatë.

Mësuesit pa cilësi edukojnë dhe formojnë njerëz si vetja, të paaftë.





23

Nëse duam nxënës pa të meta, duhet të
jemi ne, mësues pa të meta.





24

Kartvizita e mjeshtrit është vegla e
rregulluar nga dora e tij.
Kështu, edhe kualiteti i mësuesit matet
me nxënësit që ka edukuar ai.



25

Edukimi i mirë i mësuesit, është një përgjegjësi e rëndësishme, sepse një mësues pa cilësi, është thjesht konsumator i kotë i kohës së atyre nxënësve që i janë lënë në përgjegjësi.



26



Mësuesi është si bariu, përgjegjës për grigjën e tij. Qëngjin që i është thyer këmba, duhet ta mbajë në krahë.





27

Çdo njeri beson se ajo që do të thotë është me rëndësi dhe kërkon vëmendje nga të tjerët. Edhe mësuesi duhet ta dëgjojë kështu me vëmendje dhe me kujdes nxënësin që i është drejtuar atij për ndonjë problem, e jo ta shpërfillë.





28

Mësuesi duhet t'i kushtojë vëmendje
nxënësit të tij dhe ta vlerësojë atë.
Këtë ai duhet të shfaqë
edhe me sjelljet e tij.



29

Është përgjegjës para Allahut ai mësues
që nxënësi i tij ka perspektivë
të bëhet një çinar i tëri dhe mësuesi
bëhet shkak që ai të bëhet
një shkurre një metërshe.



30



Mësuesi duhet të njohë shumë mirë karakterin e nxënësit, derisa të gjejë damarët për të hyrë në zemrën e tij.





31

Ngaqë janë të ndryshme, karakteret dhe individualitetet e fëmijëve, metoda apo këshilla e njëjtë për të gjithë, njërit mund t'i bëjë mirë, tjetrit mund t'i bëjë keq, pikërisht për këtë mësuesi duhet të njohë mirë kartvizitat shpirtërore të nxënësve.







32

Si kokrrat e tespihit duhet t'i njohë
mësuesi karakteret dhe aftësitë e
nxënësve, për t'i ndihmuar ata në varësi
të veçorive që kanë.



33

Sot jemi në kohë të tilla që njerëzit, ashtu si copat e drunjëve në një vërshim uji, enden në pavetëdije. Më e keqja është, se duke pasur mundësi të rrjedhin lumenj aq të fuqishëm sa të gjallërojë toka, për arsye të këtyre specialistëve të cilët nuk i kanë orientuar në drejtimin e duhur, fatkeqësisht tokët kthehen në kënetë.





34

Mësuesi duhet të tregohet i mëshirshëm,
i drejtë dhe i singertë me nxënësit e vet,
si dhe nuk duhet t'u japë një detyrë
që s'mund ta bëjnë, sepse duhet
t'i vlerësojë të gjithë sipas
potencialit që kanë.



35

Mësuesi i drejtë është mësuesi i gjithë klasës. Nuk mund të ketë harmoni ku nuk ka drejtësi. Në një klasë që nuk ka harmoni nuk bëhet mësim dhe aty ku nuk bëhet mësim nuk ka arsim.



36

Mësuesi duhet të dijë se të qenit i drejtë nuk do të thotë të sillet në një mënyrë të barabartë me të gjithë, por të sillet në mënyrë të drejtë me të gjithë. Ai duhet t'i shmanget çdo lloj sjelljeje që njollos drejtësinë.



37

Një mësues duhet të jetë i drejtë gjithmonë, jo vetëm kur jep një gjykim, por edhe kur peshon diçka, kur dëshmon për diçka. Pra, i drejtë në çdo temë.



38

Mësuesi duhet të përgatitet duke pasur parasysh materialet e temës dhe veçoritë e klasave, për të realizuar një orë mësimi të vlefshme.





39

Një mësues që ecën me plan-program,
kupton në një orë mësimi se ku ka
mbetur, çfarë ka shpjeguar dhe se sa me
sukses e ka realizuar.





40

Mësuesi kur planifikon mësimin është i detyruar të caktojë që Ku, Kur dhe Si duhet t'i përdorë metodat pedagogjike.



41

Detyra e një mësuesi nuk është vetëm dhënia e diturisë, por edhe organizimi i orës së mësimit në mënyrë sa më tërheqëse për nxënësin, duke krijuar kështu lidhje dhe me jetën e përditshme nëpërmjet metodës pyetje-përgjigje, që ta bëjë sa më aktiv nxënësin.





42

Çelësi kryesor i suksesit në arsim është
durimi, vendosmëria dhe sakrifica.





43

Mësuesi nuk duhet të ndihet i rrezikuar
përballë vështirësive dhe rreziqeve,
përkundrazi ato duhet ta fuqizojnë atë.



48





44

Mësuesi nuk duhet të ndihet asnjëherë i
pashpresë, i pavullnet apo indiferent,
për shkak të mangësive
apo pamundësive që ai vëren.



45

Nuk duhet harruar që eliksiri i lumturisë së përhershme shpirtërore, gjendet me vështirësi dhe me mundime, prandaj ajo që e bën jetën të begatë dhe të çmuar është sakrifica dhe përpjekja e secilit prej nesh, për të arritur në një qëllim madhor.







46

Edukimi nuk është një dashuri e përkohshme, por një detyrë e lartë që duhet kryer me dashuri e dëshirë deri në frymën e fundit. Në këtë kontekst, mësuesi duhet të ushqehet përherë me durim dhe të mbështetet gjithmonë tek Krijuesi.



47

Në cilatdo situata që të gjendet mësuesi, ai duhet ta mbajë gjallërinë e besimit, ta distancojë zemrën nga interesat e ndryshme materiale dhe t'i kushtojë vëmendje thirrjeve të heshtura të zemrave nevojtare për dituri.





48

Ashtu sikur është gabim që mësuesi për hir të vullnetarizmit të tij duke shërbyer, të mënjanojë fëmijët, prindërit dhe punën me të cilën jeton, gjithashtu nuk është e drejtë që me justifikimin e këtyre të mos shërbejë.



49



Mësuesi nuk duhet të mërzhitet për ato gjëra materiale që nuk i ka realizuar, si dhe as nuk duhet të krenohet për ato gjëra materiale që ka realizuar.



50

Mësuesi duhet t'i rezervojë kohë nxënësit të tij edhe jashtë orarit të punës. Ai nuk duhet të luaj rolin e punëtorit që tregon kartën e tij në hyrje dhe dalje të punës.



Apo si nëpunësi që hedh firmën në fletën e mungesave.





51

Mësuesi nuk duhet të jetë njeri që krijon probleme, por zgjidhës i problemeve. Në vend që të përdorë fjalë e kritika apo të kërkojë gabime e të meta tek të tjerët, ai duhet t'u afrohet çështjeve me një shpirt kreativ dhe me një pikëpamje pozitive.







52

Mësuesi nuk duhet të fajësojë të tjerët për arsye të pengesave që mund të gjejë gjatë të shërbyerit, le të përmirësojë dobësitë dhe të metat e tij.



53

Mësuesit që justifikohen duke thënë:
“S’kemi ç’të bëjmë, nxënësit s’i kemi të
aftë, nuk vlejnë, është e kotë të punosh
me to!”, Zoti iu përgjigjet me frutat e
pemës së fikut, të cilat dalin nga gurët e
shkëmbinjve.





54

Edukimi është arti i të harruarit të
ankesave gjatë përballjes me vështirësitë.
Aty ku fillon ankimi dhe padurimi,
përfundon edukimi.



55

Mësuesi nuk duhet të presë t'i vijë vetë mundësitë dhe hapësirat, ai duhet të jetë vetë kërkues i shërbimit.



60



56

Edukimi nuk është punë për dembelët,
kërkon zemër të mbushur plot me
energji pozitive.



61





57

Farat e diturisë që hidhen me një shpirt
të mbushur me entuziazëm
dhe emocion, do të jenë çinarët
e së ardhmes.



58



Mësuesi duhet ta dijë mirë kodin etik që është i pëlqyer dhe i praktikuar nga njerëzit dhe s' duhet ta neglizhojë asnjëherë atë.



59

Mësuesi i dashur dhe i sjellshëm,
të shërben me një emocion prej të
devotshmi, nuk shqetëson asnjëri dhe
nuk shqetësohet nga askush.

Nuk duhet harruar se zemrat janë
vendshikimi hyjnor.





60

Mësuesi çdoherë duhet të bëjë kujdes për shprehjet dhe sjelljet e tij, madje duhet të bëjë kujdes edhe për mënyrën se si bën lojëra me shoqërinë.



61

Mësuesi duhet t'i kushtojë vëmëndje kufijve mes sinqeritetit dhe formalitetit, modestisë dhe vulgaritetit, vendosmërisë dhe mendjemadhësisë, mos t'i përziejë me njëra-tjetrën.



62

Mësuesi në çdo vendndodhje dhe sidomos në klasë, duhet të manifestojë sjellje që i përshtaten personalitetit islam dhe nuk duhet të harrojë se çdo fjalë dhe sjellje e tij vendos nga një gur në personalitetin e nxënësve.



63

Mësuesi duhet të mendojë se gjatë mësimit, që është një moment transformim gjendjesh, të metat, gabimet dhe lapsuset e tij mund të kopjohen nga nxënësit, kështu që duhet ta ndjejë përgjegjësinë mbi të sjellurit dhe të shprehurit.



64

Mësuesi duhet të përpiqet të fitojë faljen
hyjnore duke falur ai vetë.





65

Secili nga ne ka nevojë për interesim dhe vlerësim, duke u treguar më i interesuar, armikut ia pakësojmë armiqtësinë dhe miqve ua shtojmë miqtësinë.



66

Nuk arsimohet njeriu me fyerje,
ashpërsi dhe vrazhdësi.



71



67

Nuk është e pëlqyeshme
që të dhunohen nxënësit
në emër të disiplinës.



68

Ashpërsia e tepruar lind urrejtjen.
Toleranca e tepruar dobëson autoritetin.
Suksesi i arrirë është ekuilibri
tolerancë-ashpërsi.



73



69

Mënyra më e mirë për të zënë vend në zemrat e të tjerëve është ëmbëlsia, butësia dhe modestia. Një mësues i mirë duhet të jetë fjalëmbël, orator dhe gjithmonë i shprehur me fjalë të bukura, askujt nuk i pëlqejnë fjalët e rënda dhe të ashpra.





70

Sikurse piloti nuk lejohet të fluturojë kur nuk ndihet mire psikologjikisht, ashtu dhe mësuesi nuk duhet lejuar të japë mësim kur ndihet i nevrikosur apo i demoralizuar.



71

Mësuesi me qetësinë e tij duhet t'u edukojë nxënësve të tij, nxënien e mësimit, qortimin dhe këshillën. Ai nuk duhet të harrojë asnjëherë, që është një dobësi e madhe e personalitetit të tij, kur përdor sjellje fyese ndaj nxënësve.





72

Njeriu është gjithmonë nën tryshninë e ndjenjave të tij, mendon dhe vendos bashkë me to. Prandaj, mësuesi duhet të veprojë pasi të jetë konsultuar mirë, e cila i jep mundësi atij të bëjë shërbime më të drejta dhe më të begata.



73

Ndikimi që bën një mësues tek nxënësi i tij, i cili punon me emocion e përrshpirtshmëri, është sikur aroma e këndshme e një fladi që kalon nëpër një kopësht plot me trëndafila, karafila dhe lule të rralla.



74



Kjo botë bëhet xhenet në momentin
kur përcillet mëshirë me sjellje,
shprehje dhe shpirt.





75

Njerëzit e mëdhenj,
për të arritur në shpëtimin
e përhershëm, kërkojnë të kenë përreth
njerëz të edukuar, sakrifikues
dhe të mëshirshëm.





76

Triumfi i vërtetë është triumfi i zemrave,
i cili arrihet me shndërrimin
e zemrave.



81





77

Mësuesi shembullor është specialist i zemrave, është mjek që bën gjilpërën e përjetësisë.





78

Zemra e mësuesit bëhet një qendër
rehabilitimi shpirtëror, duke fituar
mënyrën e të shikuarit të krijesave sipas
këndvështrimit të Krijuesit.



79

Dashuria dhe përpjekja zgjidh çdo problem. Njeriut të cilit i kemi zgjidhur një problem, bëhet i yni. Ne jemi në brendësi të çdo sevapi që merr një njeri dhe të çdo përgjegjësie të rëndë të secilit që e humb atë.



80

Peshorja e dashurisë është sakrificë.
Fjalët e zbraza nuk shprehin asgjë.
Të pretenduarit për dashuri lind nevojën
e sakrificës për t'u vërtetuar.



81

Miqësia dhe vëllazëria duhet të
kuptohet përmes gjuhës shpirtërore.
Mësuesi duhet të njihet me problemet e
nxënësve, të gëzohet me gëzimin
e tyre dhe t'i konsiderojë ata
si shokë e vëllezër.



82

Mësues nuk është ai që përpiqet të gjejë të metat e nxënësve, por që mbulon gabimet dhe lapsuset e tyre dhe përpiqet që t'i udhëzojë ata.



83

Dashuria është lidhja e dy zemrave.
Shëndeti i arsimit është në varësi të asaj
sa krijohet mundësia e kësaj lidhjeje.





84

Mësuesi duhet t'i hap nxënësve portën e zemrës së tij deri në fund, që nxënësit t'i drejtohen të interesuar atij.



Respekti ndaj mësuesit, të zgjon interesin dhe për temat e shpjeguara prej tij. Kur mësuesi komunikon me dashuri dhe dhembshuri me nxënësin, mesazhet përçohen më fort, përmes linjës së zemrës se asaj racionale.



86

Mësuesi duhet të hyjë me respekt në
mësim sikurse hyn në faltore,
të kuptojë që materiali më i mirë
që u jep ai nxënësve të tij është
dashuria dhe vlerësimi.



87

Një dituri që nuk arrin në zemër nuk transformohet në njohje intuitive.





88

Mësuesit krijojnë një qasje për jetën duke përdorur organet më të shtrenjta të fëmijëve, zemrën dhe shpirtin, pikërisht për këtë ata mund të quhen “arkitektët e së ardhmes”.

Dituria dhe njohja intuitive mund të shpjegohen vetëm duke pasur një jetë të pasur shpirtërore të përzier me devocion, për të bërë efekt tek të tjerët. Kur arrihet kjo shkallë, njeriu vështron tjetrin me dashuri dhe fara që hidhet me dashuri është e përjetshme.



90



Për të qenë mësues duhet t'i kesh të
forta ndjenjat e dhembshurisë
dhe të mëshirës.





91

Nxënësi duhet konsideruar si një zog i plagosur që ka nevojë për mjekim, të tregohet dhembshuri dhe mëshirë për të, sepse dhembshuria dhe mëshira është eliksiri më efikas për ndërgjegjet e shëndosha.





92

Mëshira është një zjarr që kurrë nuk
shuhet në zemrën e mësuesit.



97





93

Ta bësh mësues një njeri që nuk njih
mëshirë dhe dhembshuri është të
dhunosh njerëzimin.



Sikurse pamjet me trëndafilishta
dhe me lule shumëngjyrëshe,
gëzojnë njeriun më të trishtuar dhe të
demoralizuar, ashtu dhe udhërrëfyesit e
njerëzve duhet të zbusin zemra dhe
të nxisin buzëqeshje dhe në fytyrat më
të vrazhda të mundshme.





95

Kujdes! Mësuesi të metat e gjithçkaje
duhet t'i kërkojë tek vetja e tij,
ndërsa suksesin e punëve t'ia lërë
vetëm Zotit të të gjithë botëve.



96

Mësuesi duhet ta mendojë si një dhuratë
dhe dhunti të madhe profilin e vet
dhe të jetë mirënjohës duke u treguar
përgjegjës për nxënësin si shpirtërisht
ashtu dhe materialisht.





97

Vendin e “egoizmit” dhe të “pretendimit”
tek një mësues duhet ta zërë “dashuria”
dhe “dashamirësia”.



98



Jeta e mësuesit duhet të qëndrojë mbi boshtin e sinqeritetit dhe mbi përpjekjen e shërbimit, larg rënies në sy.





99

Çdo ditë e re është një fletë e bardhë e hapur në kalendarin e jetës.
Ti e ke në dorë ta plotësosh në mënyrën më të bukur të mundshme fletën e bardhë që ke përpara.





100



Mësuesi, çdo moment që kalon me nxënësin, duhet ta vlerësojë mire, sikur është në frymën e fundit dhe të jetë mirënjohës ndaj Zotit të tij.






101

Në këtë botë, fëmija është nevojtar i edukimit të prindërve dhe mësuesve të tij. Ndërsa në botën tjetër, prindërit dhe mësuesit janë nevojtarë për çdo lloj lutjeje të mirë dhe sadakaje xharije (lëmoshë rrjedhëse, sevapi i së cilës nuk ndërpritet) që vijnë nga fëmijët që kanë edukuar.





*Disa porosi jetike nga udhërrëfyesi
më i përsosur i edukimit*

Kurani dhe Suneti:

Fjala më e bukur është vepra e Allahut.

Metoda më e mirë është metoda profetike.

Streha më e sigurt është devocioni në adhurim.

Të folurit më me virtyt është të përmendurit të Allahut.



Tregimet më të bukura gjenden në Kuran.

Rrugët më të ndritura janë rrugët udhëzuese të profetëve.

*Dija më e mirë dhe më e çmuar
është ajo që shndërrohet në njohje intuitive.*

*Mirënjohja për pasurinë e paktë është më e mirë se
mosmirënjohja për pasurinë e shumtë.*

*Justifikimi më i keq është ai që bëhet në
momentin e vdekjes.*



*Pasuria më e mirë është pasuria shpirtërore,
të ndihesh i pasur me aq sa ke.*

Pendimi më i keq është ai që bëhet në Ditën e Kiametit.

Gabimi më i madh është gënjeshtria.



Besimi më i mirë është ai që është i gdhendur në zemër.

*Pasuria pa zekat, pa bamirësi e pa lëmoshë
është faqezeza në botën tjetër.*

Fitesa më e keqe është kamata dhe fajdeja.

Verbimi më i thellë është kur del nga rruga e drejtë pasi ke hyrë.

Verbimi më i keq është verbimi i zemrave.



*Të bëhesh shkak për të hyr në besim një njeri, është më e mirë se
lindja dhe perëndimi i vetë diellit. Të bëhesh shkak për të hyr në
besim një njeri është rezultat i një edukimi të mirë shpirtëror.*

*Çdo shpërdorim ka të keqen e vet brenda, por më i keqi
është “shpërdorimi që u bëhet njerëzve”.*